



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## MARRËVESHJE

### PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Sot, më datë, 16.10.2017, Palët e mëposhtme:

**Këshilli Kombëtar i Territorit**, përfaqësuar nga Kryeministri dhe Kryetari i KKT  
Z. Edi Rama

dhe

**Bashkia Korçë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Z. Sotiraq Filo

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 14/1, pika 2, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligjit Nr. 115/2014, datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit” dhe Lejes Zhvillimore të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 12, datë 16.10.2017, për objektin: “Për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: “Terminali i autobusave Korçë”, Bashkia Korçë, bien dakord si më poshtë:

#### NENI 1 OBJEKTI

- 1.1 Objekti i kësaj marrëveshje është delegimi i kompetencave Bashkisë Korçë për kryerjen e procedurave përkatëse ligjore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në lidhje me ndërtimin e objektit: “Terminali i autobusave Korçë”, Bashkia Korçë, sipas Lejes Zhvillimore përkatëse, të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 12, datë 16.10.2017.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**NENI 2  
KOHËZGJATJA**

- 2.1 Kompetencat objekt i kësaj Marrëveshjeje do të ushtrohen nga Bashkia Korçë, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje e deri në vënien në shfrytëzim të objektit: “Terminali i autobuzave Korçë”.

**NENI 3  
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 3.1 Këshilli Kombëtar i Territorit ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Vënien në dispozicion të Bashkisë Korçë, të Lejes së Zhvillimit të miratuar me Vendimin e KKT-së Nr. 12, datë 16.10.2017, për objektin: “Terminali i autobuzave Korçë”, Bashkia Korçë, me subjekt zhvillues Bashkinë Korçë.
- dhe
- ii. Hartën e Planvendosjes së Strukturave që shoqëron këtë Vendim.
- 3.2 Bashkia Korçë ka të drejtat dhe detyrimet si më poshtë:
- i. Kryerjen e të gjitha procedurave administrative/ligjore, sipas përcaktimeve të parashikuara në dispozitat e Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, për objektin: “Terminali i autobuzave Korçë”, Bashkia Korçë.
  - ii. Shqyrtimin e dokumentacionit përkatës tekniko-ligjor, miratimin dhe lëshimin e të gjithë akteve/dokumenteve përkatëse, të parashikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, deri në vënien në shfrytëzim të objektit: “Terminali i autobuzave Korçë”, Bashkia Korçë.

MINISTRARVE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**NENI 4**  
**ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 4.1 Palët do t'i zgjidhin të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje me mirëkuptim ndërmjet tyre.

**NENI 5**  
**GJUHA E MARRËVESHJES**

- 5.1 Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe me vlerë të njëjtë.

**NENI 6**  
**EFEKTET JURIDIKE DHE PUBLIKIMI**

- 6.1 Palët bien dakord se efektet juridike të kësaj Marrëveshjeje do të fillojnë në momentin e nënshkrimit të saj.
- 6.2 Kjo Marrëveshje publikohet në Fletoren Zyrtare.

**PALËT**

**KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

Përfaqësuar nga,  
**Z. EDI RAMA**



**BASHKIA KORÇË**

Përfaqësuar nga,  
**Z. SOTIRAQ FILO**

